në zjar edhe del pa dëm: gjen dhurim, po të shohë dëm: ka dënim. Cili ha zjar: ha mall jetimi. Zjari po të bjerë në bimët: vjen shtrenjtësi. Po të bjerë në petkat: shtrenjtohen petkat. Në një lagje po të bëjerë zjar me aluri: ka ja luftë ja sëmundje me rëndësi. Zjari kur lartësohet përpjetë: atje ka kryengritje. Kush ndes zjar për të ngrohur trupin e ti: e ndjek mbarësija. Zjari po të bjerë mes qytetit: vdes një nga parësija. Zjari nga do një herë shënon edhe zi, hirin e zjarit edhe qymyrin: ca e quajnë mall të shkretë, ca e quajnë risk nga mbreti. Fjal e fundit: zjar tymuar: s'ësht mirë. Flak e kulluar: del hajir.

(ZOT-i me dije plot, e di më mirë)

Kur sheh ujë, det, vaporr, tërmet, shkrepëtim, erë: ëndra 'çkallzon?

Kush sheh det të ndriçmë: malli i shtohet, murati (qellimi) i mbarohet. Gjoli: shënon grua me pasuni. Lumi a përoj: naltësi. Kush kalon lumin: kapton helmin. Llomi po të rjedhë në shtëpi: të vjen mbarësi. Llomi i turbull: sjell prapësi. Llom i kulluar: del punim i qëruar. Reja e bardhë: ësht rahmet edhe punim. Re e kuqe a e erët: hidhërim. Shiu: del hajir edhe risk. Kush lahet në ujë të kulluar: del i gëzuar. E notuara në ujë: ësht murat. Pa ujë: qesat. Ulluku: hajir. Po në kohë pa shi po të rjedhën ullukët: s'del mirë. Kush pi ujë të kripur: fati i ka ndritur. Pusi: shënon dijë e murat. E hapura pus: evlat. E pira ujë prej pusit ose prej burimit: del mall edhe fat mirë. Kush sheh

vehten në uj të kulluar: ngopet me nimet. Në qoft i turbulluar: shënon mall të shkretë; pellgu: shënon pasuni e dituni. Cili bje në pellk e nuk del dot më nj'anë: exhelë e ka pranë, në daltë në shpëtim: kapton hidhërimin. Avulli, dhe tymi në heva: sjell bela. Breshri: sëmundje me lehtësi. Dëbora: nùr edhe qetësi. Ujrat në luadhe të jeshilta: dalin hajir edhe myslimanësi. Shkreptima: shënon dritë edhe risk të ri. Tërmeti: shënon mundim edhe ngjarje të mbëdha. Dallga, rëkeja, rufeja: janë bela. Era me tunë: hidhënim. Era edhe shiu po të punojë lehtë del shërim edhe shpëtim. Kush sheh vehten në vaporr edhe del në të thatë: ka shpëtim edhe fat. Cili sheh vehten ne vapor që nuk shkon: fati e helmon. Po të shohish vaporr: fati të jep dorë.

Kur sheh mal, fushë, pyll, dhé, grurë, drurë, metale ëndra ç'kallzou?

Kush hypë ose kush sheh vehten mbi mâl a mbi breg: gjenë mall edhe fuqi. E zbritura prej malit: të zbret nga nënpunësija. Po të shohish pyje: ëndra ësht e frikshme. Fush e gjërë: gëzim. Kopshti, ara, çifligu: del risk edhe nderim.

* * *

Dheu, guri, kumi, tulla: janë màll edhe dynjà. E bëra baltë: del hajir, po baltaxhinë se heqin mirë. E mbjella dru: lindje edhe hajir. Dru e thatë: s'del mirë. Druja ulli, hurma, shegë, manë, mollë si dhe shelgu: del mbarësì. Druja me pemë: pasuni. Po të bjerë plepi: bje armiku. Kush sheh drurë me lule të